



PERMBLEDHJE JO TEKNIKE

10 Mars 2022



**LEJE MJEDISI TIPI B
GJOKA KONSTRUKSION**

1. Hyrje

Referuar kontratës Nr. 4061/13 Prot., në datë 08.01.2021 ndërmjet Ministrisë Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë INTEKAR YAPI TURIZM ELEKTRIK INSAAT SANAYI VE TICARET LIMITED SIRKETI dhe ASL INSAAT TAAHHUT VE SINAYI TICARET LIMITED SIRKETI, nenit 1, pika 1.2.2 Gjoka konstruksion është nënkontraktor I miratuar për kryerjen e punimeve në projektin “Ndërtimi i tunelit të Llogarasë (në seksionin rrugor Orikum – Himarë pjesë e Autostradës SH8 Vlorë – Sarandë)”.

Në shërbim aktiviteteve ndërtimore që subjekti Gjoka Konstruksion do të realizoj për ndërtimin e tunelit të Llogarasë është duke djekur procedurën e pajisjes me leje mjedisi të tipit B të aktiviteteve si më poshtë:

- Impiant fraksionimi
- Impianti i prodhimit të betonit
- Depozitimi I përkohshëm I mbetjeve inerte të gjeneruara nga gërmimet e tunelit të Llogarasë

2. Impianti I fraksionimit

ID 3.10 / Industria Minerare / Prodhimi i produkteve abrazive

Gelqeroret e nxjerre nga kariera e gurit gelqeror me dimension 0-800mm futen ne nje ngushtice, rreshqasin neper kete kanal duke u ricoptuar deri ne thermim dhe me renie te lire bien poshte ne shesh pushimin. Cdo tendence pluhurosje kontrollohet gjate sperkatjes se gelqerorit me uje perpara se ai te hyje ne kanal.

Bluarja e gelqeroreve

Copetimi e gelqeroreve realizohet ne frontone e gurit me kapacitet 70 m3/h -100 m3/h, 4 transportiere. Guri nga bunkeret e shkarkimit futet ne gurthyese ku behet coptimi e tij dhe prej ketej kalon ne sistemin e fraksionimit.

Seleksionimi

Sistemi I fraksionimit eshte perbere nga nje system prej disa sitash me fraksionometri qe varion

- 0-10 mm/mm
- 10-40 mm/mm
- 40-80 mm/mm
- 80-150mm/mm

Nga sitat materiali depozitohet ne bunkere. Per eliminimin e te gjithë pluhurave qe dalin gjate procesit teknologjik te bluarjes se gurit eshte realizuar:

1. Hermetizimi dhe mirembajtje te gjithe linjes teknologjike.
2. Hermetizim i makinerise se frontojes
3. Hermetizim i dhomave te sitave
4. Sigurimi i sperkatjes me uje i gurit gjate gjithe linjes teknologjike te prodhimit te tij.



Figure 2-1: Impjanti I fraksionimit



Figure 2-2: Impianti i fraksionimit

3. Impianti i prodhimi te betonit

3.1/e/Industria Minerare/Përzierja e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzierjen e çimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhimi i blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të çimentos, si dhe prodhimi i llaçit, kollës, gëlqeres (parafabrikeve, paletave, etj.).

Proçesi i punës:

- ✓ Magazinimi i lëndëve të para.

Agregatet depozitohen dhe magazinohen në venddepozitime të ndara, ku sheshi është i mirë sisitemuar si dhe i rrethuar pranë zonës së instalimeve të nyjes së betonit.

- ✓ Peshimi i materialeve (agregateve).

Për të prodhuar beton të gatshëm, agregatet transferohen nga vend-magazinimi dhe peshohen në sasi të saktë, të përcaktuara si nga specialist përkatës.

- ✓ Peshimi i ujit dhe materialeve shtesë.

Uji dhe aditivët peshohen sipas markës së betonit. Uji është elementi që realizon miksimin e tyre me njëra tjetrën duke reaguar kimikisht me çimenton dhe shtesat e tjera. Shtesat shtohen sipas markës përkatëse të betonit.

- ✓ Çimento.

Çimentoja transferohet për në nyjen e betonit me kamionët me çisternë të posacëm, ku ajo ruhet në sillosa. Çimento është materiali më i rëndësishëm për proçesin e prodhimit të betonit. Hidratimi i çimentos, reaksioni kimik midis çimentos dhe ujit, ndikojne ne ngurtesimin e betonit. Raporti ujë/çimento përcaktojnë tipin e betonit si një element tepër i rëndësishëm, si vetitë e saj kryesore fortësia dhe qëndrueshmëria. Në varësi të markës së kërkuar, sasia e saktë e çimentos peshohet dhe shtohet në njësinë e përziertsit për përzierjen së bashku me agregatet e tjerë, ujin dhe aditivët.

- ✓ Përzierja e lëndëve të para.


Në proçesin e prodhit të betonit, koha e përzierjes së lëndëve të para është shumë specifike në mënyrë që të marrë një masë homogjene me agregatët, çimenton, ujin dhe aditivët.

Betoni është një masë e përbërë nga material inerte të thata (rërë, granil) dhe nga cimento e aditivë të ndryshëm që ndihmojnë procesin e tharjes e të ngrirjes së betonit. Kjo përbërje është një material natyror dhe i riciklueshem dhe është i përdorshëm në një gamë të gjerë në fushën e ndërtimit, mund të përdoret për bordurat e rrugëve, pistave të ndryshme, shesheve të ndryshme,

pistave dhe fushave sportive, vepra arti të ndryshme si ura, mbikalime e nënkalime, kolona mbajtëse, ndërtesa banimi e shërbimesh, etj.

Betoni prodhohet në këtë mënyrë: Në sillosat e furnizimit me lëndë të parë me inerte, hidhet rërë dhe granil i përmasave të ndryshme, sipas cilësisë së kërkuar të betonit. Nga këtu, inertet kalojnë në mikser nëpërmjet transportierëve të cilët punojnë me energji elektrike. Në mikser, pasi kryhet përzierja e tyre, shtohet edhe cimento e lëngët dhe aktivë të ndryshëm për të krijuar cilësinë dhe vetitë e kërkuara të betonit. Kryhet miksimi ose përzierja e elementeve përbërës dhe pastaj kalon menjëherë në sillosen e ngarkimit të kamioneve që do të kryejnë transportimin e betonit për në vendin e përdorimit, në kantierin e ndërtimit.

Prodhimi i betonit realizohet sipas skemës së mëposhtme:



Materialet inerte që do të përdoren për prodhimin e betonit sipas klasave të ndryshme janë të cilësisë së lartë dhe konform kushteve të cilësisë për këto produkte. Inerti që përdoret është i larë dhe sigurohet nga karierrat e prodhimit të këtyre materialeve.

5.10 b

Menaxhimi i mbetjes inerte jo të rrezikshme

Mbetjet inerte që do të gjenerohen nga hapja e tunelit do të depozitohen pranë hyrjes së tij dhe do të përdoren si lëndë e parë për imjantin e fraksionimit.

